



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania,

Tel/Fax 04 22268141 ; 22268142

Nr. 1704 Prot.

Tiranë, më 12.03.2015

V E N D I M

Nr. 23, datë 12.03.2015

Bazuar në nenet 11, 14 dhe 15, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenet 80-104, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, mbi inspektimin e përgjithshëm në lidhje me gjendjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar,

V Ë R E J:

Gjatë muajit Dhjetor 2014, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka marrë dijeni për disa probleme që lidhen me administrimin e shërbimit civil nga Departamenti i Administratës Publike, në lidhje me deklarimin/refuzimin e statusit të punësimit për punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Pasi u kryen verifikimet në disa prej praktikave të procesit të deklarimit apo refuzimit të statusit të punësimit, rezultoi se, për një pjesë të tyre, vlerësimet apo qëndrimet e mbajtura nga njësia e personelit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike ishin të pabazuara në ligj. Nisur nga sa më sipër, u pa e nevojshme që të shqyrtohej e gjithë procedura e deklarimit/refuzimit të statusit të punësimit të punonjësve të SHGJSH-së, si dhe të këqyrej mënyra e plotësimit të përshkrimeve të punës, e kërkesave të veçanta për secilin pozicion pune, mënyra e implementimit të ndryshimeve në strukturë, etj. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Urdhrin Nr. 1, datë 09.01.2015, filloi procesin e inspektimit të përgjithshëm në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar për problemet e mëposhtme:

- Si janë kuptuar e zbatuar dispozitat e Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me statusin e punonjësve ekzistues, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
- Kontrolli i ligjshmërisë së procedurës së ndjekur nga institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesave të ligjit në fjalë, si dhe evidentimi i shkaqeve, të cilat mund të kenë ndikuar në konkluzionet apo vendimmarrjen e organeve, të cilat, në zbatim të Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, kryejnë deklarinë e statusit të punësimit.
- Rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e procesit të deklarimit/refuzimit të statusit të punësimit nëse vërehen shkelje të procedurës dhe kushteve të përcaktuara në Nenin 67, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.
- Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, dhe VKM Nr. 142, datë 12.3.2014, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*". Nëse i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme të vendit të punës të përcaktuara në këto akte punonjësit që janë emëruar dhe deklaruar nëpunës civilë.
- Si është zbatuar procedura e deklarimit/refuzimit të statusit të punësimit dhe cili është pozicioni i këtij procesi në raport me ristrukturimin e fundit të kryer në zbatim të strukturës së re, miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*".

Inspektimi përfshiu verifikimin e mënyrës së punësimit në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, praktikën e deklarimit apo refuzimit të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit e tij, si dhe mënyrën e dokumentimit të këtij procesi në dosjet e personelit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës me kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, për pozicione të ndryshme, mënyrën e implementimit të strukturës së re të institucionit, miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.4.2014, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*", etj.

Procesi i inspektimit dhe hetimit administrative u krye pasi u administrua dhe u analizua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kopje e versionit elektronik të materialit, nisur nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për Departamentin e Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse.
- Aktet e deklarimit të statusit për të gjithë punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të lëshuara nga Departamenti i Administratës Publike.
- Struktura e punonjësve të SHGJSH-së, efektive në datë 24.02.2014.
- Listëpagesat e muajit shkurt 2014 të të gjithë punonjësve të institucionit.
- Tabela me emrat e punonjësve dhe vjetërsia në punë e tyre në SHGJSH, deri më datë 01.04.2014.
- Struktura dhe organigrama e punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, miratuar me VKM Nr. 465, datë 12.2.2013, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës për SHGJSH*", me lëvizjet e punonjësve të kryera nëpërmjet shkresave Nr. 228 Prot., dhe Nr.234 Prot., datë 24.02.2014, "*Emërime dhe transferime në detyrë*".

- Struktura dhe organigrama e punonjësve të SHGJSH me ndryshimet pas ristrukturimit të institucionit sipas strukturës së miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014.
- Shkresa e Departamentit të Administratës Publike Nr. 1353/3, datë 30.06.2014, "*Mbi transferimin për shkak të ristrukturimit të disa nëpunësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*".

Në analizë të dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar është përfshirë për herë të parë në shërbimin civil, me fillimin e efekteve të Ligjit Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, duke u bërë pjesë përbërëse e "*Listës së institucioneve të Administratës Shtetërore*".

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", sipas strukturës së miratuar me VKM Nr. 465, datë 13.02.2013, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së SHGJSH*", rezulton se është **133**, për të cilët, pas analizës dhe vendimmarrjes së bërë nga Departamenti i Administratës Publike, në lidhje me zbatimin e Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, është vendosur si më poshtë:

- për **118** punonjës, Departamenti i Administratës Publike e ka përfunduar procesin e deklarimit të statusit të punësimit pozitivisht, nga të cilët, **86** punonjës janë deklaruar nëpunës civilë; **32** punonjës janë deklaruar nëpunës civilë në periudhë prove;
- për **6** punonjës është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit me arsyetimin se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit kanë qenë të punësuar në pozicione pune që nuk plotësojnë karakteristikat për t'u përfshirë në shërbimin civil;
- për **2** punonjëse është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për shkak të shkurtimit të vendit të punës pas ristrukturimit të kryer në bazë të VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*";
- pjesa që mbetet, janë punonjës të sektorit mbështetës që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar nga grupi i inspektimit, për **118** punonjësit për të cilët është vendosur deklarimi i statusit të nëpunësit civil rezulton se, për pjesën më të madhe të tyre është konkluduar me të drejtë se ekzistojnë kushtet e parashikuara nga Neni 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, dhe si të tillë e përfitojnë statusin e nëpunësit civil.

Në shqyrtim u morën edhe **6** rastet për të cilët ishte refuzuar deklarimi i statusit të punësimit, me arsyetimin se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit kanë qenë të punësuar në pozicione pune që nuk plotësojnë karakteristikat për t'u përfshirë në shërbimin civil.

Në përfundim u konstatua se, në **20** raste kishte kuptim dhe zbatim të gabuar të kërkesave të ligjit, e konkretisht Nenit 67, duke cenuar në këtë mënyrë ligjshmërinë e procesit të deklarimit të statusit të punësimit.

Zbatimi i gabuar i Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar ka ardhur si pasojë e kuptimit jo të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë hyrjen në fuqi të akteve administrative (*nenet 111 deri 113 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*), si dhe interpretimit të gabuar të akteve administrative objekt shqyrtimi, të cilat kanë sjellë pasoja në emërimet apo transferimet në detyrë të punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Konkretisht, nga hetimi administrativ rezultoi se në datë 24.02.2014 (*dy ditë para fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar*), Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ka nxjerrë dy urdhra me objekt: "Emërimet dhe transferimet në detyrë", me Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014 dhe Nr. 234, datë 24.02.2014. Me këto urdhra janë bërë emërimet të reja dhe lëvizjet të brendshme të punonjësve, duke përcaktuar për secilin prej tyre pozicionin ku emëroheshin apo transferoheshin, nivelin e pagës dhe kohën e fillimit të detyrës, që korrespondonte me fillimin e marrëdhënieve financiare (*sipas rastit në datë 06.03.2014, 01.04.2014, në Maj 2014, etj*).

Departamenti i Administratës Publike, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit që përmenden në këto akte, me fillimin e efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", në zbatim të Nenit 67 të tij ka marrë të mirëqenë si ditën e fillimit të efekteve të punësimit datën 24.02.2014, që përkon me nxjerrjen e këtyre akteve (si për ata punonjës që punësoheshin për herë të parë pranë këtij institucioni, ashtu edhe për pjesën tjetër që transferoheshin në pozicione të tjera), pa u njohur me vetë rregullimet apo përmbajtjen e akteve. Për rrjedhojë, procesi i deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit që përmenden në këto akte është bërë në pozicionet që janë përcaktuar në to dhe jo në pozicionet që kanë patur realisht në datën e fillimit të efekteve të ligjit.

Ky veprim vlerësohet i kryer në kundërshtim me mënyrën se si duhet kuptuar dhe zbatuar legjislacioni që rregullon hyrjen në fuqi të akteve administrative dhe funksionimin e administratës publike.

Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se aktet administrative objekt shqyrtimi Nr. 228 Prot., dhe Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, "*Emërimet dhe transferimet në detyrë*" janë akte administrative individuale që rregullojnë një marrëdhënie konkrete të posaçme për një çështje të caktuar, ndaj një grupi subjektësh të identifikueshëm, që në rastin konkret janë punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Edhe pse vetë akti nuk e ka përcaktuar karakterin e tij individual, ai del nga vetë përmbajtja e tij, nga marrëdhënia juridike që rregullon, si dhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijon për subjektet ndaj të cilëve shtrin efektet. Pavarësisht nga fakti se në këto akte janë përmendur më shumë se një subjekt, ato në përmbajtjen e tyre shprehin veçmas për secilin prej tyre në lidhje me marrëdhënien që rregullojnë dhe efektet që sjellin.

Nga përmbajtja e tyre, konstatohet se ato rregullojnë marrëdhënien juridike të punës, si dhe të drejtat e detyrimet e secilës palë që rregullohen nga këto marrëdhënie. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në momentin e daljes së akteve administrative, i rregullonte marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të tij sipas dispozitave të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995, "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, të cilat në kuptim të Nenit 11 të tij rregullohen sipas

përparësisë së disa burimeve, ku midis të tjerave është edhe rregullorja e brendshme e institucionit.

Edhe pse midis punonjësve dhe institucionit nuk ka patur një kontratë pune të mirëfilltë, siç përcaktohet në Nenin 12 e vijues të Kodit të Punës, këto akte nga përmbajtja dhe marrëdhënia që rregullojnë do të konsiderohen si të tilla në kuptim të Nenit 21/2 të Kodit të Punës në të cilin theksohet se: “Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëdhënësi pranon kryerjen e punës për një kohë të caktuar ose të pacaktuar, në kuadrin e organizimit dhe nën urdhrat e tij dhe që në bazë të këtyre rrethanave kryhet vetëm kundrejt pagesës”.

E parë në këtë kontekst këto akte administrative që rregullojnë këtë marrëdhënie të posaçme, duhet të përmbajnë njëkohësisht të gjitha elementet e marrëdhënies së punës. Marrëdhënia e punës lind me përmbushjen e tre kushteve: ekzistencën e pozicionit të punës, kryerjen e detyrës nga nëpunësi përkatës dhe pagesën për punën e kryer. Nëse njëri nga këta elementë nuk ekziston, atëherë nuk mund të flitet për marrëdhënie pune apo nëse një nga këta elementë ndryshon, atëherë lind një marrëdhënie e re pune.

Arsyetimi i bërë nga Departamenti i Administratës Publike në lidhje me këto dy akte administrative, duke pretenduar se: “Në rastin konkret nuk rezulton që të ndodhemi përballë rasteve të parashikuara nga Neni 113 i KPrA, për fillimin e efekteve të vonuara të aktit. Po kështu, vetë akti nuk rezulton të jetë shprehur në lidhje me ndonjë efekt të vonuar në vetë përmbajtjen e tij. Shprehja që ekziston në shkresën nr. 228 prot. datë 24.02.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të SHGJSH-së se efektet financiare fillojnë më datë 06.03.2014, nuk sjell efekt të vonuar të aktit. ...”, është i gabuar pasi vjen në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Në nenin 111 të KPr Administrative parashikohet se aktet administrative hyjnë në fuqi ditën e miratimit të tyre, duke përjashtuar rastin kur vetë akti i jep *fuqi të vonuar*.

Në dy aktet administrative objekt shqyrtimi konstatohet se është vendosur, rast pas rasti, fillimi i efekteve të tij. Duke qenë akte individuale që rregullojnë një marrëdhënie juridike të posaçme siç është marrëdhënia e punës, ato detyrimisht duhet të përcaktonin në përmbajtjen e tyre edhe elementët e kësaj marrëdhënieje që në kuptim të Kodit të Punës janë dita e fillimit të punës e për rrjedhojë dhe e efekteve financiare të tyre.

Në kundërshtitë e paraqitura nga Departamenti i Administratës Publike merret në analizë si rast vetëm rregullimi i marrëdhënies së transferimit të brendshëm të bërë me këto akte, por nuk përmenden rastet e punësimit për herë të parë në këtë institucion për disa punonjës, që variojnë nga data 6 mars deri në Maj 2014, kohë në të cilën edhe punonjësit janë paraqitur efektivisht në punë.

Fakti që në aktet e emërimit apo transferimit është shënuar një datë e mëvonshme për fillimin e efekteve financiare do të thotë se urdhërdhënësi ka shprehur vullnetin që këto marrëdhënie pune të krijuara apo ndryshuara të bëhen efektive në momentin e lidhjes së marrëdhënieve financiare dhe jo në momentin e daljes së aktit.

Sa më sipër, konstatojmë se, pavarësisht datës së formulimit dhe nënshkrimit të akteve Nr. 228 Prot. dhe Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, këto akte nuk kishin hyrë në fuqi, pasi kishin të caktuar në vetë përmbajtjen e tyre ditën e fillimit të gjithë efekteve juridike për secilin nga subjektet e përmendura në to.

Në këto kushte, deklarimi i statusit të punësimit në rastin konkret duhej të bëhej në bazë të gjendjes faktike të punësimit në datë 26.02.2014, domethënë, të pozicionit të punës që kanë patur realisht nëpunësit ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe vetëm për ata punonjës që kanë qenë efektivisht të punësuar pranë ShGjSh-së në atë datë. Ky moment duhet të përbëjë kriterin bazë të vlerësimit për të arritur në konkluzionin se në cilin pozicion pune duhet deklaruar statusi i punësimit për secilin punonjës.

Një aspekt tjetër që duhet evidentuar është edhe fakti se struktura e re, miratuar me VKM Nr.228 Prot., datë 23.04.2014, është implementuar pa u bërë më parë deklarimi i statusit të punësimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Konkretisht, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, *"Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të SHGJSH"* ka miratuar transferimin e 44 punonjësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, pa deklaruar më parë statusin e punësimit të tyre në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*. Për më tepër, ky deklarim është bërë dy muaj më pas në pozicionet që punonjësit kanë marrë pas lëvizjeve për shkak të ristrukturimit e ku, për një pjesë të tyre, statusi i punësimit është deklaruar në pozicione të tjera nga ato që u takonin realisht në kuptim të ligjit.

Këta punonjës janë trajtuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike si nëpunës civilë dhe janë lëvizur në pozicione të ndryshme brenda strukturës në një kohë që nuk ishte bërë deklarimi i statusit të punësimit sipas kërkesave të Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar. Ky veprim ka sjellë anomali në kuptimin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve që ndryshuan pozicionin e punës në raport me atë pozicion që kishin efektivisht ditën e fillimit të efekteve të ligjit. Deklarimin e statusit të punësimit Departamenti i Administratës Publike e ka bërë afro dy muaj pas kryerjes së këtyre lëvizjeve të punonjësve, me shkresën Nr. 1191/1 Prot., datë 14.08.2014, *"Verifikimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë"*. Nga sa më sipër, rezulton se me shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, *"Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar"*, të Departamentit të Administratës Publike, janë trajtuar si nëpunës civilë punonjës që ende nuk u ishte deklaruar statusi i punësimit.

Ligji Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në Nenin 7 të tij, përcakton qartë se, Departamenti i Administratës Publike është organ që menaxhon krejt shërbimin civil në fushën që është përcaktuar, por ky administrim shtrihet vetëm tek nëpunësit civilë. Sa kohë nuk ishte bërë deklarimi i statusit të punësimit për punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ata akoma nuk ishin përfshirë në fushën e shërbimit civil dhe Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, nuk mund të ushtronte kompetencën e tij si njësi përgjegjëse, menaxhuese e shërbimit civil, ashtu siç përcakton Neni

4, pika f, dhe Neni 50, pika 3, i këtij ligji. Për këtë arsye, veprimi i kryer nga Departamenti i Administratës Publike duhet të konsiderohet i kryer në kapërcim të kompetencës, gjë e cila në kuptim të Nenit 116, pikat b dhe c, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative në RSH*", passjell pavlefshmëri të veprimit administrativ.

Nga sa më sipër, konstatojmë se nëse Departamenti i Administratës Publike do të kishte respektuar radhën e punës që kërkon zbatimin e ligjit (dmth, nëse do të ishin nxjerrë fillimisht aktet e deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit pasi të kishin përfunduar përshkrimet e reja të punës me kërkesat e përgjithshme e të veçanta për secilin pozicion e pastaj të bënte implementimin e strukturës së re) do të ishin evituar deklarime apo refuzime të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin.

Pretendimi i SHGJSH-së në lidhje me pikën III, germa A, të observacionit të paraqitur në datë 20.02.2015, sipas të cilit: "... *Aktet e DAP për konfirmimin e deklarimit të statusit të punësimit, edhe pse kanë datën 14.08.2014, i takojnë momentit të fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*", është i gabuar. Në lidhje me këtë pretendim theksojmë se:

Së pari, verifikimet e bëra nga Komisioneri në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit nuk kanë qenë formale, duke iu referuar vetëm datës së nxjerrjes së tyre, por janë mbështetur në njohjen dhe analizën e përmbajtjes së tyre.

Së dyti, nga përmbajtja e akteve për deklarimin e statusit të punësimit dhe hetimit administrativ të kryer nga Komisioneri ka rezultuar se, për disa prej tyre (më hollësisht do të përmenden në vijim të kësij vendimi), deklarimi i statusit është bërë sipas transferimit për shkak të ristrukturimit.

Së treti, statusi i nëpunësit civil lind vetëm në kushtet kur plotësohen njëherësh të gjitha kërkesat e Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", në momentin e fillimit të efekteve të këtij ligji, në datën 26.02.2014. Në varësi të kohës reale të punësimit në vendin përkatës të punës që kishte secili punonjës në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, sipas rastit do të deklarohesh nëpunës civil apo nëpunës civil në periudhë prove, por gjithmonë duke patur si pikë referimi pozicionin e punës që ai mbante efektivisht në datë 26.02.2014.

Bazuar në gjetjet e mësipërme, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me njësinë e personelit pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, duhet të bëjë edhe një herë deklarimin e statusit të punësimit për të gjithë punonjësit e SHGJSH-së, duke respektuar aktet ligjore e nënligjore, si dhe të gjitha aktet administrative, sipas kronologjisë së fillimit të efekteve të tyre juridike. Në këtë procedurë duhet të përfshihen edhe problemet konkrete të trajtuara në vijim, të cilat kanë të bëjnë gjithashtu me kuptim dhe zbatim të gabuar të aspekteve të ndryshme të legjislacionit për shërbimin civil.

Së pari, sikundër është përmendur edhe më sipër, janë evidentuar 20 raste të veçanta, me parregullsi të dukshme, në lidhje me deklarimin/refuzimin e statusit të punësimit ose lëvizjen në detyrë të punonjësve, në kundërshtim me statusin potencial që ata kishin përfituar ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, për të cilët është

bërë një analizë e hollësishme dhe janë nxjerrë përfundimet e rastit në pjesën vijuese të këtij vendimi.

Nisur nga parregullsitë e konstatuara dhe përmendura më sipër, ardhur kryesisht për shkak të mosrespektimit të procedurës ligjore dhe radhës së punës, moskuptimit dhe moszbatimit të drejtë të Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, moskuptimit të drejtë të mënyrës së fitimit të fuqisë juridike të akteve administrative me efekt të vonuar, etj., të cilat kanë sjellë si pasojë vendimmarrje të gabuar në procesin e deklarimit apo refuzimit të statusit të punësimit për punonjës të ndryshëm në kundërshtim me statusin që ata potencialisht përfitonin në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; lind domosdoshmëria e marrjes së masave të mëposhtme për të kthyer gjendjen e ligjshmërisë.

A. Si rjedhojë e këtyre qëndrimeve, ky proces, në disa raste, ka çuar në nxjerrjen e akteve në kundërshtim me dispozitat ligjore, të cilat duhet të revokohen nga vetë organi që i ka nxjerrë. Konkretisht:

1. Punonjësi ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar më 1 shtator 2008 në pozicion specialisti. Me shkresën Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, *“Emërime dhe Transferime në detyrë”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, është larguar nga pozicioni *“Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare”* në Drejtorinë e Gjeologjisë dhe është emëruar *“Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë”* në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, duke theksuar se marrëdhënia e punës dhe ajo financiare në këtë pozicion fillojnë me paraqitjen në punë në datë 1 prill 2014.

Me miratimin e strukturës së re me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr.1353/3 Prot., datë 30.06.2014, *“Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”* ka vendosur kalimin e këtij nëpunësi në këtë pozicion dhe më pas, me shkresën Nr. 1191/1 Prot., datë 14.08.2014, *“Verifikimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual”*, e ka deklaruar këtë punonjës *“nëpunës civil në periudhë prove”*, po në këtë pozicion. Pavarësisht deklarimit të statusit të tij në pozicionin e *“Përgjegjës të Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë”*, fillimi i efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, e ka gjetur realisht në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare”* në Drejtorinë e Gjeologjisë. Kjo rezulton nga fakti se ky punonjës, pavarësisht emërimit në pozicionin e përgjegjës të sektorit me shkresën Nr.234 Prot., datë 24.02.2014, *“Emërime dhe transferime në detyrë”*, paraqitja e tij në këtë detyrë ishte caktuar në datë 1 prill 2014.

Nga sa më sipër, rezulton se, në datë 26.02.2014, ky nëpunës nuk ka qenë në detyrën e përgjegjës të sektorit, por ka qenë në detyrën e *“Specialistit në Sektorin e Hapësirës Bregdetare”*, pozicion në të cilin duhej të ishte bërë dhe deklarimi i statusit, në kuptim të Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Në varësi të periudhës kohore që kishte në këtë pozicion pune duhej të bëhej edhe deklarimi i statusit të punësimit: *“nëpunës civil ose nëpunës civil në periudhë prove”*.

Për më tepër, deklarimi i statusit në një detyrë të një niveli më të lartë se ajo që punonjësi ***** mbante realisht ditën e fillimit të efekteve të ligjit vjen në kundërshtim me Nenin 26, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe VKM Nr. 143, datë 12.3.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", në lidhje me procedurën që parashikohet për ngritjen në detyrë.

Si përfundim, për punonjësin ***** duhet të revokohet deklarimi i statusit si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë dhe të bëhet deklarimi i statusit të nëpunësit civil për atë pozicion që mbante në datën 26.02.2014, "Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare".

Pozicioni "Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë" duhet të shpallet i lirë dhe punonjësi ***** duhet të sistemohet në një pozicion tjetër të përshtatshëm me nivelin e statusit të specialistit ose të marrë pjesë në plotësimin e vendit të Përgjegjës të Sektorit të Arkivit Qendror nëpërmjet procedurës së konkurimit për ngritjen në detyrë.

2. Punonjësi ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në prill të vitit 2000 në pozicion specialisti. Në 16 shtator 2013 ka kaluar në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë" në Drejtorinë e Programim - Zhvillimit. Me shkresën Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, "Emërimet dhe Transferimet në detyrë", të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, është larguar nga pozicioni "Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë" në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit dhe është emëruar në pozicionin "Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare" në Drejtorinë e Gjeologjisë, duke theksuar se marrëdhënia e punës dhe efektet financiare fillojnë me paraqitjen në punë në datë 1 prill 2014.

Departamenti i Administratës Publike, në kuadër të implementimit të strukturës së re, miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, me shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, "Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar" ka vendosur kalimin e punonjësit ***** , "Specialist në Sektorin e Monitorimit të Lejeve të Kërkim-Zbulimit" në Drejtorinë e Burimeve Minerale.

Më pas, me shkresën Nr. 1191/1 Prot., datë 14.08.2014, "Verifikimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual" ka deklaruar statusin e nëpunësit civil në pozicionin "Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare" në Drejtorinë e Gjeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Në këto kushte, pavarësisht se ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" ai punonte efektivisht në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë" dhe për shkak të ligjit përfitonte statusin e nëpunësit civil në këtë pozicion, duke qenë se ka pranuar të punojë në pozicionin "Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare", deklarimi i statusit të nëpunësit civil në një nivel më të ulët

nëpunësie konsiderohet i drejtë. Nisur nga fakti që në datën e daljes së aktit të deklarimit të statusit ***** mbante pozicionin *“Specialist në Sektorin e Monitorimit të Lejeve të Kërkim-Zbulimit në Drejtorinë e Burimeve Minerale”*, për shkak se është ruajtur i njëjti nivel nëpunësie me pozicionin e mëparshëm, Departamenti i Administratës Publike duhet të bëjë korrigjimin e aktit të deklarimit të statusit, duke shënuar në të pozicionin që ***** mban aktualisht.

3. Punonjësja ***** ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në pozicionin *“Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”*, në datë 01.04.2014 (pra, pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*), pavarësisht se formalisht akti i emërimit ka dalë në një datë të mëparshme, me shkresën Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014. Departamenti i Administratës Publike me shkresën Nr. 1191/85 Prot., datë 14.08.2014 ka deklaruar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove për këtë punonjëse në pozicionin *Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*. Në kuptim të Nenit 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, siç kemi parashtruar edhe më sipër, për të përfutur statusin e nëpunësit civil:
- një punonjës duhet të jetë i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil;
 - të jetë i rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurrese, sipas asaj të përcaktuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Statusi nëpunësit civil”*; apo
 - të ketë qenë i punësuar në atë vend për një periudhë jo më të vogël se një vit. Nëse periudha e punësimit është më e vogël se një vit do të konsiderohet nëpunës civil në periudhë prove.

Në rastin e ***** konkludojmë se nuk ekziston asnjë prej kushteve të mësipërme. Kjo punonjëse ka filluar punë realisht në datën 1 prill 2014, pra pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*. Në zbatim të ligjit, për të filluar punë në pozicionin *Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*, pozicion që përfshihet në shërbimin civil, pranimi në punë duhet të bëhet në respektim të procedurave të përcaktuara në nenet 22 e vijues të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 143, datë 12.3.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*.

Sa më sipër, për rregullimin e ligjshmërisë për këtë rast duhet të kërkohet nga Departamenti i Administratës Publike të bëjë revokimin e aktit të nxjerrë për deklarimin e statusit për këtë punonjëse dhe pozicionin *Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar* ta shpallë vend të lirë për t'u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

4. Punonjësi ***** ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me shkresën Nr 381 Prot., datë 18.04.2011, "Emërim në detyrë" në pozicionin

“Specialist në Sektorin e Vendburimeve Metalore në Drejtorinë e Burimeve Minerale”. Më pas, është emëruar *“Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike”* në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, pozicion të cilin e ka mbajtur deri kur me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, *“Emërime dhe transferime në detyrë”*, ****

*** emërohet *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*. Pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, Departamenti i Administratës Publike me shkresën Nr. 1191/86 Prot., datë 14.08.2014, *“Akti i Deklarimit të statusit të punësimit”* ka deklaruar statusin e punësimit për këtë punonjës *“nëpunës civil në periudhë prove”* në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*.

Konstatohet se, akti i deklarimit të statusit të punësimit bie ndesh me kërkesat e Nenit 67, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi fillimi i efekteve të tij e ka gjetur këtë punonjës të punësuar në pozicionin *“Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike”* në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë. Rezulton se marrëdhënia e punës për këtë punonjës në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*, emëruar me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, *“Emërime dhe transferime në detyrë”* ka filluar efektivisht me paraqitjen në detyrë më datë 6 mars 2014.

Në këto kushte, vlerësojmë se kemi kuptim dhe zbatim të gabuar të dispozitave që rregullojnë deklarimin e statusit të punësimit. Për punonjësin ***** , lindja e të drejtës për përfitimin e statusit të nëpunësit civil lidhet ngushtë me pozicionin që mbante në datë 26.02.2014 *“Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike”*. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit në pozicionin e përgjegjësit të sektorit, qoftë edhe në periudhë prove, është i gabuar.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast duhet që Departamenti i Administratës Publike të revokojë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin ***** në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit* dhe të bëjë deklarimin e statusit në pozicionin *“Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike”*, ku ka qenë realisht i punësuar ditën e fillimit të efekteve të ligjit dhe pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit* ta shpallë vend të lirë për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

5. Punonjësi ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, *“Emërime dhe transferime në detyrë”*, në pozicionin *“specialist në sektorin e Hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë”*. Në këtë urdhër theksohet se marrëdhënia e punës dhe ajo financiare për këtë punonjës fillojnë me paraqitjen në punë në datë 6 prill 2014. Departamenti i Administratës Publike me shkresën Nr. 1191/48 Prot., datë 14.08.2014, *“Akti i deklarimit të statusit të punësimit”* ka deklaruar statusin e nëpunësit civil për këtë punonjës, *“nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Specialist në Sektorin e Hartografisë, në Drejtorinë e Gjeologjisë”*.

Në kuptim të Nenit 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, për të përfituar statusin e nëpunësit civil:

- a. një punonjës duhet të jetë i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil;
- b. të jetë i rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurrese sipas asaj të përcaktuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Statusi nëpunësit civil*"; apo
- c. ditën e fillimit të efekteve të ligjit në fjalë, të ketë qenë i punësuar në atë vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit.

Në rastin e këtij punonjësi konkludojmë se nuk vërtetohet asnjë prej kushteve të mësipërme, pasi nga administrimi i dokumentacionit ka rezultuar se ai është paraqitur në detyrë dhe marrëdhënia financiare i ka filluar për herë të parë në datë 1 maj 2014.

Sa më sipër, rezulton e provuar se ditën e fillimit të efekteve të ligjit, në datë 26.02.2014, ai nuk ka qenë punonjës efektiv në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe, si i tillë, nuk mund të përfitojë nga mundësia që jep Neni 67 për fitimin e statusit të nëpunësit civil. Për çdo marrëdhënie të re pune që lidhet pas ditës së fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në bazë të nenit 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurimi pasi, çdo emërim që vjen në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast duhet që Departamenti i Administratës Publike të revokojë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin ****
**** në pozicionin "Specialist në sektorin e Hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë". Pozicioni i tij i punës duhet të shpallet pozicion i lirë dhe për këtë duhet të zhvillohet procedura e konkurimit.

6. Punonjësi *****, në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" ka kryer funksionin e "*Përgjegjës të Sektorit të Vendburimeve Jometalore*" në Drejtorinë e Burimeve Minerale pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Me ristrukturimin e bërë në zbatim të strukturës së re të miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.4.2014, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së SHGJSH*", me cilësinë e njësise përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr.1353/3 Prot., datë 30.06.2014, "*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*" ka vendosur kalimin e këtij punonjësi në detyrën me të njëjtin nivel dhe kategori punësimi, "*Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*", në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, ku punon edhe aktualisht.

Më pas, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/29 Prot., datë 14.08.2014, "*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*", ka deklaruar për punonjësin ***** statusin e nëpunësit civil në pozicionin "*Përgjegjës në Sektorin e Vendburimeve Jometalore*" në Drejtorinë e Burimeve Minerale, detyrë të cilën e mbante para ristrukturimit. Meqenëse pas daljes së aktit Nr.1353/3 Prot., datë 30.06.2014, të

Departamentit të Administratës Publike, ky pozicion figuronte i lirë, me shpalljen Nr. 122 nisi procedura e konkurimit në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ky konkurim tashmë ka përfunduar dhe pozicioni në fjalë figuron i zënë.

Duke qenë se në transferimin e bërë me shkresën Nr.1353/3 Prot., datë 30.06.2014, të Departamentit të Administratës Publike është ruajtur niveli dhe kategoria e nëpunësisë, duhet që Departamenti i Administratës Publike të ndryshojë/korrigjojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, duke shënuar pozicionin që ky punonjës mban sot: “Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë.

7. Punonjësi ***** , që prej vitit 2008, ka qenë i punësuar në pozicionin “*specialist-topograf në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, “*Emërim dhe transferime në detyrë*”, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, duke theksuar se marrëdhënia e punës dhe efektet financiare të tij fillojnë në datë 06.03.2014.

Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës Nr. 1191/59 Prot., datë 14.08.2014, “*Akti i Deklarimit të Statusit të punësimit*”, duke mos vlerësuar drejt rastin, e deklaroi ***** “*nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”. Ndërkohë, përpara miratimit të këtij vendimi, për shkak të ndryshimit të strukturës me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014 dhe futjes së institucionit të SHGJSH në procesin e ristrukturimit, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike ka vendosur kalimin e nëpunësit ***** nga pozicioni “*Përgjegjës në sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Dinamikës Detare*”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare. Ky ndryshim nuk është patur parasysh nga DAP-i në nxjerrjen e vendimit për deklarimin e statusit të nëpunësit civil për këtë punonjës.

Nga verifikimi i akteve të mësipërme, konstatohet se marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për nëpunësin ***** në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”, ku edhe është deklaruar statusi i nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues kanë filluar efektivisht në datë 06.03.2013 pra, mbas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”. Në kuptim të Nenit 67 të këtij ligji, ky punonjës duhej të ishte deklaruar nëpunës civil në pozicionin që mbante në momentin e fillimit të efekteve të tij në datë 26.02.2014, si *specialist në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë.

Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike duhet të revokojë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues për punonjësin ***** si “Përgjegjës në sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë” dhe të deklarojë statusin e nëpunësit civil për pozicionin që ka mbajtur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit (datë 26.02.2014) si “specialist në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”.

8. Punonjësi ***** është punonjës i vjetër i strukturave të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Me aktin Nr. 1365 Prot., datë 14.10.2013, "*Emërime dhe transferime në detyrë*", është emëruar "*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor*", pozicion të cilin e ka mbajtur edhe ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013. Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/76 Prot., datë 14.08.2014, "*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*", ka deklaruar statusin e nëpunësit civil në këtë pozicion.

Ndërkaq, me shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, "*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*", Departamenti i Administratës Publike, në kuadër të zbatimit të strukturës së re, miratuar me VKM Nr.228 Prot., datë 23.04.2014, e ka kaluar këtë punonjës në pozicionin "*Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare*".

Caktimi në një detyrë të një niveli më të lartë, pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*" është kryer në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji. Fakti që në momentin e fillimit të efekteve të tij ka qenë në një nivel nëpunësie të kategorisë së nivelit të ulët drejtues dhe për këtë pozicion pune ekzistonin kushtet për deklarimin e statusit të punësimit, bëhet pengesë që të kalojë në një nivel nëpunësie më të lartë, pa respektuar kërkesat e Nenit 26, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe të VKM Nr. 143, datë 12.03.2014, "*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*".

Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike duhet të revokojë shkresën Nr.1353/3 Prot., datë 30.06.2014, "*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*". Nëse ekzistojnë mundësitë, të sistemohet në një pozicion që përshtatet me nivelin e tij të nëpunësisë. Pozicioni *Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare* duhet të deklarohet pozicion i lirë nga Departamenti i Administratës Publike dhe të shpallet procedura e konkurimit për plotësimin e tij sipas ligjit.

9. Punonjësi ***** është punonjës i vjetër i strukturave të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Me shkresën Nr. 1365 Prot., datë 14.10.2013, ky punonjës është transferuar nga pozicioni i "*Përgjegjës të Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor*" në pozicionin "*Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Lumor*".

Departamenti i Administratës Publike, në kuadër të implementimit të strukturës së miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, me aktin Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, "*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*", e ka kaluar punonjësin ***** në pozicionin "*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë*" dhe më pas, me shkresën Nr. 1191/78 Prot., datë 14.08.2014, "*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*", ka deklaruar me të drejtë statusin e nëpunësit civil për këtë punonjës në pozicionin "*Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Lumor*".

Ndërsa, sa i takon kalimit nga niveli ekzekutues i nëpunësisë në atë të nëpunësit të nivelit të ulët drejtues siç është “*përgjegjësi i sektorit*”, ky veprim duhej bërë vetëm duke respektuar procedurën e caktuar në Ligjin Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe VKM-në Nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Sa më sipër, konstatohet se kalimi i punonjësit ***** nga niveli i “*specialistit*” në nivelin e “*përgjegjësit të sektorit*” është një veprim i kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Ky pozicion pune “*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë*” duhet të shpallet pozicion i lirë dhe nga ana e Departamentit të Administratës Publike të fillojnë veprimet për plotësimin sipas procedurave ligjore, nëpërmjet konkurimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, etj.

10. Punonjësja ***** ka filluar punë në strukturat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar më 01.02.1985. Me aktin Nr. 1241 Prot., datë 16.09.2013, lirohet nga detyra e mëparshme dhe kalon në detyrën “*specialiste në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” dhe në të njëjtën kohë komandohet si “*përgjegjëse e sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeodezisë në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”. Me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, ndërpritet komandimi dhe emërohet në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Analizave të Mineraleve*” në Drejtorinë e Laboratorit, ku paraqitja në këtë detyrë dhe fillimi i efekteve financiare përkojnë me datën 6 mars 2014 (kjo vërtetohet si nga shënimi në librezën e saj të punës, ashtu edhe nga listëpagesat e muajve shkurt-mars).

Me shkresën Nr. 1191/112 Prot., datë 14.08.2014, “*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*”, Departamenti i Administratës Publike deklaron statusin e nëpunësit civil për ***** në pozicionin “*specialist*” në sektorin e analizave të mineraleve në Drejtorinë e Laboratorit, pozicion në të cilin ajo ka kaluar në datë 06.03.2014, në zbatim të shkresës Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, “*Emërime dhe transferime në detyrë*”. Megjithatë niveli i punësimit nuk ka ndryshuar, veprimi i DAP për deklarimin e statusit në nivelin e specialistes është i drejtë.

11. Punonjësja ***** ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në datë 06.03.2014, me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, “*Emërime dhe transferime në detyrë*”, në pozicionin “*Specialist në sektorin e Hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë*”, duke theksuar se marrëdhënia financiare do të fillojë në datë 06.03.2014, pra, pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/60 Prot., datë 14.08.2014, “*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*”, ka deklaruar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove për këtë punonjëse në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës*”, në kundërshtim me ligjin pasi, në kuptim të Nenit 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për të përfituar statusin e nëpunësit civil:

- a. një punonjës duhet të jetë i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil;
- b. të jetë i rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese sipas asaj të përcaktuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi nëpunësit civil*”; ose
- c. të ketë qenë i punësuar në atë vend për një periudhë jo më të vogël se një vit. Nëse periudha e punësimit është më e vogël se një vit do të konsiderohet nëpunës civil në periudhë prove.

Në rastin e ***** konkludojmë se nuk ekziston asnjë prej kushteve të mësipërme. Ditën e fillimit të efekteve të ligjit në datë 26.02.2014, punonjësja ***** duhej të ishte realisht në marrëdhënie pune në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës*”. Fakti që punësimi efektiv i saj në këtë pozicion ka filluar në datë 06.03.2014, bën që ajo të mos përfitojë nga mundësia që jep Neni 67, i Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Në këto kushte, duhet që Departamenti i Administratës Publike të bëjë revokimin e aktit për deklarimin e statusit për punonjësën ***** dhe pozicioni i punës “*Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës*”, ku aktualisht punon e sipërpërmendura, duhet të shpallet pozicioni i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 22 e 23 të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

12. Punonjësi ***** ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me aktin e emërimit Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, “*Emërime dhe transferime në detyrë*”, në pozicionin “*specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”, duke theksuar se marrëdhënia financiare do të fillojë në datë 06.03.2014, pra, pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/65 Prot., datë 14.08.2014, “*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*”, ka deklaruar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në pozicionin “*specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” pa vlerësuar drejt faktet.

Në kuptim të Nenit 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, indryshuar, për të përfituar statusin e nëpunësit civil:

- a. një punonjës duhet të jetë i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil;
- b. të jetë i rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese sipas asaj të përcaktuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi nëpunësit civil*”; ose

- c. të ketë qenë i punësuar në atë vend për një periudhë jo më të vogël se një vit. Nëse periudha e punësimit është më e vogël se një vit do të konsiderohet nëpunës civil në periudhë prove.

Në rastin e ***** konkludojmë se nuk ekziston asnjë prej kushteve të mësipërme. Ditën e fillimit të efekteve të ligjit në datë 26.02.2014, punonjësi ***** duhej të ishte realisht në marrëdhënie pune në pozicionin "*specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*". Duke qenë se punësimi efektiv i tij në këtë pozicion ka filluar në datë 06.03.2014, ai nuk përfiton nga mundësia që jep Neni 67 i Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Në këto kushte, duhet që Departamenti i Administratës Publike të bëjë revokimin e aktit për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësin ***** në pozicionin "*specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*". Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, "*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*".

13. Punonjësi ***** ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me aktin e emërimit Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, "*Emërimet dhe transferimet në detyrë*", në pozicionin "*specialist në sektorin e Analizave të Ujrave në Drejtorinë e Laboratorit*", duke përcaktuar se marrëdhëniet e punës dhe ajo financiare fillojnë me paraqitjen në punë në datë 6 mars 2014, pra, pas datës së fillimit të efekteve të Ligjit Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që është data 26.02.2014.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/1 Prot., datë 14.08.2014, "*Verifikimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë*", e ka deklaruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin "*Specialist në Sektorin e Analizave të Ujrave*" në Drejtorinë e Laboratorit, pa vlerësuar drejt faktet, pasi, në kuptim të Nenit 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, për të përfituar statusin e nëpunësit civil:

- një punonjës duhet të jetë i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil;
- të jetë i rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese sipas asaj të përcaktuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Statusi nëpunësit civil*"; ose
- të ketë qenë i punësuar në atë vend për një periudhë jo më të vogël se një vit. Nëse periudha e punësimit është më e vogël se një vit do të konsiderohet nëpunës civil në periudhë prove.

Si konkluzion, që të jemi përpara rasteve të parashikuara nga kjo dispozitë duhej që, ditën e fillimit të efekteve të ligjit në datë 26.02.2014, punonjësi ***** të ishte realisht

në marrëdhënie pune në pozicionin *“Specialist në sektorin e Analizave të Ujrave”*. Fakti që punësimi efektiv i tij në këtë pozicion ka filluar në datë 06.03.2014 pra, pas fillimit të efekteve të ligjit, bën që ai të mos përfitojë nga mundësia që jep Neni 67 i Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Në këto kushte, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, Departamenti i Administratës Publike duhet të bëjë revokimin e aktit të deklarimit të statusit për punonjës *******, si *“Specialist në sektorin e Analizave të Ujrave”*, ku punon aktualisht dhe ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*

14. Punonjësja ******* ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, me shkresën Nr. 192 Prot., datë 14.02.2014, *“Emërim në punë”* në pozicionin *“Specialiste e Burimeve Njerëzore, në Sektorin e Administratës, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse”*.

Me shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, *“Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”*, Departamenti i Administratës Publike ka vendosur transferimin e kësaj punonjëseje në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Dinamikës Detare, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare”*. Pavarësisht kësaj, konstatohet se Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/110, datë 14.08.2014, *“Akti i deklarimit të statusit të punësimit”*, me të drejtë ka deklaruar që nëpunësja ******* ka përfituar statusin *“nëpunës civil në periudhë prove”*, në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Administratës, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve”*.

Edhe në këtë rast, konstatohet se ******* është lëvizur në një pozicion tjetër, *“Specialist në Sektorin e Dinamikës Detare, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare”*, në një kohë që nuk ishte bërë deklarimi i statusit të saj në pozicionin që kishte efektivisht në punë ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, sipas kërkesave të nenit 67 të tij. Kjo është një gjendje paligjshmërie e cila kërkon kryerjen e disa veprimeve për përmirësimin e saj, nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit dhe Departamenti i Administratës Publike. Konkretisht, meqenëse nuk kemi ndryshim të nivelit të nëpunësisë, ndërmjet dy pozicioneve, atij *“Specialiste e Burimeve Njerëzore, në Sektorin e Administratës, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse”* dhe pozicionit *“Specialiste në Sektorin e Dinamikës Detare, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare”*, nuk përbën shkelje të ligjit, rikonfirmimi nga ana e DAP-it i deklarimit të statusit të punësimit të punonjës ******* në pozicionin ku punon aktualisht *“Specialiste në Sektorin e Dinamikës Detare, në Drejtorinë e Gjeologjisë Detare”*, nëse është vlerësuar pozitivisht, në përfundim të periudhës së provës.

C. Në lidhje me verifikimin e dokumentacionit dhe vendimmarrjen e Departamentit të Administratës Publike për refuzimin e statusit për disa punonjës të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, konstatohet se në dy raste ka kuptim dhe interpretim të gabuar të ligjit. Konkretisht:

15. Punonjësja ***** ka filluar punë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në vitin 1999 si specialiste në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit. Në 01.03.2003 është emëruar *"Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të dhënave"* po në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, pozicion në të cilin ka qëndruar edhe pas ristrukturimit të institucionit, bërë në kuadër të implementimit të strukturës së miratuar me VKM Nr.465, datë 13.02.2013, *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së punonjësve të SHGJSH"*. Fillimi i efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"* në datë 26.02.2014 e ka gjetur këtë punonjëse në të njëjtin pozicion, në atë të *"Përgjegjëses së Sektorit të Përpunimit të të dhënave"* në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në të cilin duhej të ishte deklaruar edhe statusi i nëpunësit civil

Me aktin administrativ Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, *"Emërimet dhe transferimet në detyrë"*, kjo punonjëse është liruar nga detyra e përgjegjëses dhe ka kaluar *"specialiste"* në të njëjtin sektor, duke theksuar se marrëdhënia e punës dhe ajo financiare fillojnë në datë 06.03.2014, pra, pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*. Në këto kushte, në kuptim të Nenit 67, pika 3 e ligjit në fjalë, punonjësja ***** e ka fituar statusin e nëpunësit civil në pozicionin *"Përgjegjëse e Sektorit të Përpunimit të të Dhënave"*. Duke qenë se aktualisht ka pranuar dhe kryen detyrën e *"specialistes"* në të njëjtin sektor, në kushtet kur ky pozicion është përfshirë në shërbimin civil, bën që të mos ketë pengesë ligjore për të përfutur statusin në pozicionin ku ajo punon, pavarësisht se është i një niveli më të ulët.

Departamenti i Administratës Publike nuk e ka deklaruar statusin e nëpunësit civil për punonjësen ***** me arsyetimin se, në momentin e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, ky pozicion nuk ka qenë i përfshirë në shërbimin civil.

Me Vendimin Nr. 7, datë 30.01.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike që, në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së mosdeklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për deklarimin e statusit në pozicionin *"specialiste në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit"*.

16. Punonjësja ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në vitin 2001, në pozicionin e specialistit dhe, më pas, në datë 01.09.2008 ka kaluar *"Përgjegjëse e Sektorit në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit"*. Pas miratimit të strukturës me VKM Nr. 465, datë 13.02.2013, kjo punonjëse me shkresën Nr. 1656/8 Prot., datë 14.06.2013, ka kaluar në pozicionin *"Specialiste në Sektorin e Analizave të Ujrave në Drejtorinë e Laboratorit"*.

Më pas me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, "*Emërime dhe transferime në detyrë*" të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** lirohet nga kjo detyrë dhe kalon "*Specialiste e Përpunimit të Provave*" në të njëjtin sektor dhe në të njëjtën drejtori, duke theksuar se efektet e tij do të fillojnë me paraqitjen në detyrë në datë 06.03.2014.

Emërtesa "*Specialiste e Përpunimit të Provave*" nuk përputhet me emërtesën e këtij pozicioni në strukturën e miratuar me VKM Nr. 465, datë 13.02.2013, sipas të cilës ky pozicion mban emërtesën "*laborant*", me arsim të mesëm dhe me pagesë të kësaj kategorie.

Departamenti i Administratës Publike nuk ka deklaruar statusin e nëpunësit civil për këtë punonjëse me arsyetimin se pozicioni i punës "*laborant në sektorin e analizës së ujrave në Drejtorinë e Laboratorit*" nuk përmban karakteristikat e një pozicioni pune që përfshihet në shërbimin civil.

Konkluzioni i mësipërm nuk është rezultat i një analize të plotë dhe të bazuar në ligj, pasi punonjësja ***** , në datë 26.02.2014, ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", ka qenë efektivisht e punësuar në pozicionin "*Specialiste në Sektorin e Analizave të Ujrave në Drejtorinë e Laboratorit*", pozicion i cili ishte pjesë e shërbimit civil sipas strukturës së mëparshme. ***** e mbante këtë pozicion që prej datës 14.06.2013. Për këtë arsye, në kuptim të Nenit 67, pikat 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, punonjësja ** ***** , ditën e fillimit të efekteve të ligjit ka fituar "*ipso jure*" statusin e punësimit si nëpunëse civile në pozicionin "*Specialiste në Sektorin e Analizave të Ujrave në Drejtorinë e Laboratorit*" dhe, meqenëse në këtë pozicion kishte më pak se një vit, duhej të deklarohet nëpunëse civile në periudhë prove.

Ndërkaq, duke qenë se me strukturën aktuale, të miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, edhe pozicioni i punës që mban aktualisht pas emërimit të datës 24.02.2014, "*Specialiste (laborante) në Sektorin e Analizave të Ujrave në Drejtorinë e Laboratorit*" është përfshirë në shërbimin civil, duhet t'i deklarohet statusi i nëpunësit civil për këtë pozicion, duke mënjeluar kështu veprimin e mundshëm nga Departamenti i Administratës Publike dhe njësia përgjegjëse për deklarimin e përfundimit të marrëdhënies së punësimit, siç përcaktohet në pikën 6 të Kreut III, të VKM Nr. 116, datë 5.3.2014, "*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*". Ky rast është trajtuar hollësisht në Vendimin Nr. 8, datë 30.01.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është kërkuar shprehimisht rivlerësimi i rastit duke deklaruar për këtë punonjëse statusin e nëpunësit civil në pozicionin "*Specialiste në Sektorin e Analizave të Ujrave në Drejtorinë e Laboratorit*".

- C. Në katër rastet e tjera, me të drejtë është refuzuar deklarimi i statusit, por arsyetimi në lidhje me këtë refuzim është i gabuar. Të katër punonjësit në fjalë janë punësuar pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar pas fillimit të efekteve të ligjit. Në këto kushte, pranimi

në shërbimin civil duhej të ishte bërë sipas procedurës së përcaktuar në nenet 22-24, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Konkretisht:

17. Punonjësja ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në datë 01.04.2014, me aktin e emërimit me efekt të vonuar Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, "Emërime dhe transferime në detyrë", në pozicionin "Specialiste në sektorin e Dixhitalizimit në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit. Nga hetimi administrativ është arritur në konkluzionin se, pavarësisht emërtesës "specialist" në aktin e emërimit Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, "Emërime dhe transferime në detyrë", në strukturën e miratuar me VKM-në Nr. 465, datë 13.02.2013, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", pozicioni i punës ku është emëruar ***** mban emërtesën "Teknik i specialiteteve të ndryshme. Gjeolog", një pozicion i karakterit teknik që nuk përmban karakteristikat e shërbimit civil.

Nisur nga sa më sipër, si dhe nga fakti që marrëdhënia e punës për këtë punonjëse ka filluar pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1951/3 Prot., datë 16.04.2014, me të drejtë nuk e ka përfshirë ***** në deklarin e statusit të punësimit.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë duhet që Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, ta shpallin të lirë pozicionin e punës që mban aktualisht kjo punonjëse, meqenëse në strukturën aktuale është përfshirë në shërbimin civil dhe ky pozicion të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit.

18. Punonjësja ***** ka filluar punë për herë të parë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar me aktin e emërimit Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, në pozicionin "specialiste në sektorin e Arkivit Qendror të Gjeologjisë në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit". Por, ashtu si në rastet e mësipërme, pavarësisht se akti i emërimit në detyrë mban datën 24.02.2014, në të është urdhëruar që marrëdhënia financiare të fillojë në datë 06.03.2014, pas fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/115 Prot., datë 14.08.2014, "Akti i deklarin e statusit të punësimit", e ka refuzuar deklarin si nëpunëse civile në pozicionin "Specialiste në sektorin e Arkivit Qendror të Gjeologjisë në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit" me arsyetimin se pozicioni i punës në fjalë, në strukturën e miratuar me VKM Nr. 465, datë 13.2.2013 dhe në bazë të Urdhërit Nr. 4, datë 30.01.2014, "Për miratimin e kriterëve të punësimit të SHGJSH sipas pozicioneve të punës dhe strukturës së miratuar", nuk përmbushte kriteret e një pozicioni pune që përfshihet në shërbimin civil, pa vlerësuar momentin e fillimit të marrëdhënies së punës pas fillimit të efekteve të ligjit.

Interpretimi i mësipërm i Departamentit të Administratës Publike është i gabuar për faktin se, nisur nga data e fillimit të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare, punonjësja ***** , ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik

Shqiptar më datë 6 mars 2014 , mbas fillimit të efekteve të ligjit. Për këtë arsye, ajo nuk përfiton nga mundësia që jep Neni 67 i Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Bazuar në sa më sipër, duke qënë se pozicioni i punës që ajo mban aktualisht, me strukturën e re, miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, është përfshirë në fushën e shërbimit civil, duhet të konsiderohet pozicioni i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurave të rregullta të konkurimit.

19. Punonjësja ***** ka filluar punë për herë të parë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar me aktin e emërimit Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, në pozicionin “*specialiste në sektorin e Arkivit Qendror të Gjeologjisë në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit*”. Por, ashtu si në rastin e mësipërm, pavarësisht se akti i emërimit në detyrë mban datën 24.02.2014, në të është urdhëruar që marrëdhënia financiare të fillojë në datë 06.03.2014, pas datës së fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/115 Prot., datë 14.08.2014, “*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*”, e ka refuzuar deklarinimin si nëpunëse civile në pozicionin “*Specialiste në sektorin e Arkivit Qendror të Gjeologjisë në Drejtorinë e Programim Zhvillimit*” me arsyetimin se pozicioni i punës në fjalë, në strukturën e miratuar me VKM Nr. 465, datë 13.2.2013 dhe në bazë të Urdhërit Nr. 4, datë 30.01.2014, “*Për miratimin e kriterëve të punësimit të SHGJSH sipas pozicioneve të punës dhe strukturës së miratuar*”, nuk përmbushte kriteret e një pozicioni pune që përfshihet në shërbimin civil, pa vlerësuar momentin e fillimit të marrëdhënies së punës pas fillimit të efekteve të ligjit.

Interpretimi i mësipërm i Departamentit të Administratës Publike është i gabuar për faktin se, nisur nga data e fillimit të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare, punonjësja ***** , ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar më datë 6 mars 2014 , mbas fillimit të efekteve të ligjit. Për këtë arsye, ajo nuk përfiton nga mundësia që jep Neni 67 i Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Bazuar në sa më sipër, duke qënë se pozicioni i punës që ajo mban aktualisht, me strukturën e re, miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, është përfshirë në fushën e shërbimit civil, duhet të konsiderohet pozicioni i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurave të rregullta të konkurimit.

20. Punonjësi ***** ka filluar punë për herë të parë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar me aktin e emërimit Nr. 234, datë 24.02.2014, në pozicionin “*specialist në sektorin e përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*”. Por, ashtu si në rastin e mësipërm, pavarësisht se akti i emërimit në detyrë mban datën 24.02.2014, në të është theksuar se marrëdhënia financiare do të fillojë në datë 01.04.2014, pas datës së fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën Nr. 1191/1 Prot., datë 14.08.2014, *“Akti i deklarimit të statusit të punësimit”*, e ka refuzuar deklarin si nëpunës civil në pozicionin *“specialist në sektorin e përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”* me arsyetimin se pozicioni i punës në fjalë, në strukturën e miratuar me VKM Nr. 465, datë 13.2.2013 dhe në bazë të Urdhërit Nr. 4, datë 30.01.2014, *“Për miratimin e kriterëve të punësimit të SHGJSH sipas pozicioneve të punës dhe strukturës së miratuar”*, nuk përmbushte kriteret e një pozicioni pune që përfshihet në shërbimin civil, pa vlerësuar momentin e fillimit të marrëdhënies së punës pas fillimit të efekteve të ligjit.

Interpretimi i mësipërm i Departamentit të Administratës Publike është i gabuar për faktin se, nisur nga data e fillimit të marrëdhënies së punës dhe asaj financiare, punonjësi ***** , ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar më datë 1 prill 2014 pra, mbas fillimit të efekteve të ligjit. Për këtë arsye, ai nuk përfiton nga mundësia që jep Neni 67 i Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Bazuar në sa më sipër, meqenëse pozicioni i punës që ai mban aktualisht, me strukturën e re, miratuar me VKM Nr. 228 Prot., datë 23.04.2014, është përfshirë në fushën e shërbimit civil, duhet të konsiderohet pozicioni i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurave të rregullta të konkurimit.

Së dyti, janë konstatuar të meta edhe në procesin e kuptimit dhe zbatimit të VKM Nr. 142, datë 12.3.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* dhe Udhëzimit Nr.1, datë 07.04.2014, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*. Nga shqyrtimi i formularëve të përshkrimit të pozicioneve të punës dhe kërkesave të përgjithshme e të veçanta që karakterizojnë secilin pozicion është konstatuar se, ndërsa ka patur një reagim në kohë dhe janë bërë përpjekje për të bërë formulimin e akteve të përshkrimit të punës sipas kërkesave të dispozitave përkatëse, ka patur keqkuptim në mënyrën e zbatimit konkret të tyre.

Konkretisht, konstatohet se përshkrimet e reja të punës janë konceptuar të lidhura në mënyrë direkte me karakteristikat e personave konkretë që punojnë në ato vende pune dhe jo si përshkrime të vendit të punës, ku mund të punësohet cilido shtetas, mjaft të plotësojë kërkesat e përgjithshme e të veçanta dhe të respektojë procedurën e pranimit në punë. Kështu psh., në përshkrimin e punës së pozicionit *“Specialist në Sektorin e Shelfit Kontinental”*, nuk është vënë si kërkesë koha minimale e vjetërsisë në punë që duhet të plotësojë nëpunësi që do të punësohet në këtë pozicion, por si e tillë është shënuar vjetërsia e përgjithshme në punë që ka nëpunësi i punësuar, 14 vjet; ose në përshkrimin e pozicionit *“Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”* janë shënuar gjithë të dhënat e personit që është punësuar aty dhe jo kërkesat për pozicionin e punës (psh., vjetërsia në punë është shënuar mbi 25 vjet, pra aq sa e ka vjetërsinë e përgjithshme në punë personi konkret dhe jo vjetërsia në një profesion të caktuar që duhet të ketë një nëpunës që të vlerësohet si i përshtatshëm për atë detyrë,...etj.).

Kjo parregullsi vërehet tek të gjitha përshkrimet e punës. Për këtë arsye, rregullimi i kësaj situatë duhet të jetë objekt i një trajtimi të menjëhershëm nga njësia e personelit. Për ndreqjen e

gjendjes së ligjshmërisë sa i takon formularëve të përshkrimit të pozicioneve të punës, duhet të veprohet menjëherë, duke i dhënë formën që kërkon legjislacioni për shërbimin civil. Në këto formularë duhet të zërthehen karakteristikat kryesore të pozicionit të punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore tekniko-administrative, kushtet e punës, vendimmarrja, vartësia, kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës, pa i lidhur këto me karakteristikat personale të punonjësit që është aktualisht në këtë pozicion. Këta elementë të përshkrimit të vendit të punës duhet të qëndrojnë si një e tërë, pa u varur nga cilësitë e personit që punon në të, të cilat mund të jenë sa ato që kërkon vendi i punës ose më të larta.

Së treti, parregullsi janë konstatuar edhe në aspektin e plotësimit të dosjeve të personelit, të cilat paraqiten me mangësi të ndryshme sa i takon dokumentacionit të punonjësve në raport me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Për këtë arsye, është e nevojshme të plotësohen në mënyrë urgjente dosjet e personelit, duke filluar me përmbytjen e gjithë të dhënave të Fletës-Prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit dhe gjithë dokumentacionin e kërkuar nga VKM Nr.117, datë 05.03.2014, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, e posaçërisht nga Lidhja 1 që shoqëron këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 14 dhe 15, pika 1, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar deklarimin e statusit si “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin e *Përgjegjës të Sektorit të Arkivit Qendror* dhe t’i njihet statusi i nëpunësit civil për atë pozicion që mbante në datën 26.02.2014, *“Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare”*.

Pozicioni i punës *“Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror” të SHGJSH* duhet të shpallet i lirë dhe punonjësi ***** duhet të sistemohet në një pozicion tjetër të përshtatshëm me nivelin e statusit të specialistit ose të marrë pjesë në plotësimin e pozicionit të *“Përgjegjës të Sektorit të Arkivit Qendror”*, nëpërmjet procedurës së konkurimit për ngritjen në detyrë.

2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të ndryshojë/korrigjojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , duke shënuar në këtë akt pozicionin që punonjësi mban aktualisht: *“Specialist në Sektorin e Monitorimit të Lejeve të Kërkim-Zbulimit”*, në Drejtorinë e Burimeve Minerale.

3. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimete nevojshme administrative për të revokuar deklarin e statusit si “nëpunës civil” për këtë punonjëse.

Pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*” ta shpallë vend të lirë pune, për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

4. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*” dhe të bëjë deklarin e statusit në pozicionin “*Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike*”, ku ka qenë i punësuar ditën e fillimit të efekteve të ligjit.

Pozicioni *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit* të shpallet vend të lirë për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

5. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar deklarin e statusit si “nëpunës civil” në pozicionin “*Specialist në sektorin e Hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë*”.

Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit.

6. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues për punonjësin ***** si “*Përgjegjës në sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” dhe të deklarojë statusin e tij për pozicionin që ka mbajtur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit si “*specialist në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”.

7. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të revokojë shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, “*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit*”.

Gjeologjik Shqiptar“ për kalimin e punonjësit ***** në pozicionin *Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare*, si të pambështetur në ligj, për shkak se ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, ai mbante pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor*”. Të shikohet mundësia për sistemimin e tij në një pozicion që përshtatet me nivelin e tij të nëpunësisë. Vendi i punës *Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare* duhet të deklarohet pozicion i lirë dhe të shpallet procedura e konkurimit për plotësimin e tij sipas ligjit.

8. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimeve të nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin e punës, “*Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës*”.

Pozicioni i punës, “*Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës*”. duhet të shpallet pozicion i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 22 e 23, të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

9. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimete nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”.

Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

10. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Analizave të Ujrave*”.

Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të*

përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

11. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të ndryshojë/korrigjojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , duke shënuar në këtë akt pozicionin që punonjësi mban aktualisht: *“Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”*, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë.
12. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të revokojë shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, *“Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”*) për kalimin e punonjësit ***** në një pozicion të një niveli më të lartë nëpunësie, për shkak të mosrespektimit të kërkesave të Ligjit Nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*.

Për këtë arsye, të shikohet mundësia e sistemimit të tij në një pozicion që përkon me nivelin e tij të punësimit si specialist. Pozicioni i punës *“Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor, në Drejtorinë e Hidrogjeologjisë”* duhet të deklarohet pozicion i lirë dhe të shpallet procedura e konkurimit për plotësimin e tij sipas procedurave ligjore, nëpërmjet konkurimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, etj.

13. Komisioni i Ristrukturimit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të bëjë edhe një herë rivlerësimin nga e para, të të gjithë praktikave të procesit të deklarimit apo mosdeklarimit të statusit të punësimit, për gjithë punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, duke patur parasysh kërkesat e Nenit 67, të Ligjit Nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe të VKM Nr. 116, datë 05.03.2014, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”*.
14. Të kërkoj nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar që të përgatiten përshkrimet e reja të punës, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kërkesat e përgjithshme e të veçanta për secilin vend pune, sipas standardit dhe kërkesave të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, VKM-së Nr. 142, datë 12.3.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 07.04.2014, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*, dalë në bazë e për zbatim të tij. Pasi të jetë përfunduar ky proces duhet të bëhet vlerësimi rast pas rasti nëse punonjësi që punon në një vend të caktuar pune i plotëson ose jo kërkesat konkrete të vendit të punës. Në rast se konstatohet se një nëpunës nuk plotëson kërkesat e përgjithshme apo ato të posaçme për atë pozicion ku është punësuar të veprohet sipas urdhërimit të pikës 6, të Kreut III, të VKM Nr. 116, datë 05.03.2014, *«Për statusin e nëpunësve dhe*

punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar". Pasi të përfundojnë përshkrimet e reja të vendeve të punës, në zbatim të pikës 20, të Kreut IV, të VKM Nr. 116, datë 05.03.2014, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të depozitohen pranë Departamentit të Administratës Publike. Nëse prej këtij të fundit do të vërehet se përshkrimet nuk do të jenë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard duhet t'i kthejë për rishikim.

15. Të kërkoj nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të plotësohen dosjet e personelit, duke filluar me plotësimin e të gjitha të dhënave të Fletës-Prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit dhe gjithë dokumentacionin e kërkuar nga VKM Nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"*, e posaçërisht nga Lidhja 1 që shoqëron këtë vendim.
16. Detyrat e përmendura në pjesën urdhëruese të këtij vendimi duhet të përmbushen brenda një afati prej **30 ditësh** nga marrja dijeni e këtij vendimi.
17. Në përfundim të këtij afati, Departamenti i Administratës Publike dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil lidhur me mënyrën e zbatimit dhe përfundimin e detyrave të lëna.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA